



Termet e Referencës Grupi Punues për Informim

QËLLIMI

Grupi Punues për Informim është themeluar me vendim të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media për të hartuar Strategjinë për Digjitalizim të Republikës së Kosovës (tash e tutje Strategjia) – pjesën për informim të strategjisë.

FUNKSIONI

Funksioni i Grupit Punues për Informim është të hartojë pjesën për informim të Strategjisë, të hartojë planin e veprimit për promovim dhe vetëdijësim të publikut rreth kalimit në transmetim digjital, të merr pjesë në takime me publikun për diskutimin e draftit, të bashkëpunojë me katër grupet tjera punuese për strategjinë e digjitalizimit dhe të jap kontributin e tyre në finalizimin e Strategjisë.

Funksioni i Grupit punues skadon me finalizimin e Strategjisë.

PËRBËRJA E GRUPIT PUNUES:

Grupi punues për Informim përbëhet nga këta anëtarë:

Emri	Pozita
Daut Demaku	Kryesues, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
Fikrete Çoçaj	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
Gentiana Çavdarbasha	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
Herolinda Zragrja	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
Sanije Imeri	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
Flora Saraçi	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
Ardiana Musmurati	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
Sebahate Hajredinaj	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
Luljete Islamaj	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
Esad Kasumi	Staf mbështetës, KPM
Agim Uka	Staf mbështetës, KPM

Për punën e këtij grupi nuk ka nevojë të ketë angazhim të madh të njerëzve nga jashtë; pos mbajtjes së kontakteve të rregullta dhe të efektshme me mediat përmes së cilave do të bëhet informimi dhe promovimi i punës në hartim të strategjisë. Sidoqoftë, **Anëtarët shtesë do të vendosen pas diskutimit me Këshillin**

Grupi Punues për Informim ka të drejtë që kohë pas kohe të ftojë ekspertë të jashtëm për çështje të caktuara për të cilat mungon ekspertiza brenda grupit punues. Në këtë rast, GP për informim duhet të konsultohet me Zyrën e Shefes Ekzekutive të KPM-së për miratim.

Nëse një anëtar i Grupit Punues nuk mund të vijë në takim ai nuk ka të drejtë të dërgojë zëvendësim.

KUORUMI

Kuorumi përbëhet nga 50% të anëtarëve të Grupit Punues për Informim..

TAKIMET

Grupi Punues për Informim do të takohet të paktën 2 herë në muaj

MBLEDHJET

Agjenda e takimeve dhe dokumentet tjera që kanë të bëjnë me punën e *Grupit Punues për Informim* do t'i dërgohen Grupit disa ditë para mbledhjeve që t'u ipet anëtarëve mundësi të familjarizohen me materialet.

Pas cdo mbledhjeje do të hartohet procesverbali i cili do të ratifikohet në mbledhjen e radhës. Pas ratifikimit, procesverbali nënshkruhet nga Kryesuesi i Grupit punues.

OBLIGIMET E ANËTARËVE TË GRUPIT

Të gjithë anëtarët e grupit duhet:

- Të pranojnë një kopje dhe të lexojnë ligjin për KPM-në dhe materialet tjera të prodhuara nga aktivitetet e KPM-së për digjitalizim.
- Të japin kontribut aktiv në grup punues;
- T'i respektojnë termat e referencës së Grupit;
- Të deklarojnë konflikt (eventual) të interes në fillim të takimit.